



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE

Nr. 2857 Prot.

Nr. 2163 Prot.

Datë 06.05.2020

Datë 06.05.2020

UDHËZIM I PËRBASHKËT

“PËR PËRCAKTIMIN E LISTËS SË MALLRAVE DHE SHËRBIME PËR PËRBALLIMIN  
E SITUATËS SË KRIJUAR NGA EPIDEMIA COVID-19”

Nr. 284 Datë 06.05.2020

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (në vijim “MSHMS”) dhe Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim “APP”), në mbështetje të Ligjit Nr.10138, datë 11.05.2009 “Për shëndetin publik”, i ndryshuar; të Ligjit Nr.15, datë 10.03.2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të Aktit Normativ Nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19” dhe të VKM nr.343, datë 27.4.2020 “Për përcaktimin e autoriteteve kontraktore që do të prokurojnë, me procedurë me negociim pa shpallje, mallra ose shërbime të nevojshme për përballimin e situatës së shkaktuar nga COVID -19”, me qëllim garantimin nga institucionet publike, të kushteve dhe artikujve higjeno-sanitarë të nevojshme për kufizimin e përhapjes së COVID-19, si dhe në kuadër të bashkëpunimit institucional,

UDHËZOJNË

1. Çdo autoritet kontraktor, qoftë ky organ qendror blerës apo autoritet kontraktor që do të prokurojë vet nevojat e tij, për mallra dhe shërbime të nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë, duhet t’i referohet këtij Udhëzimi të Përbashkët, në përcaktimin e objektit të prokurimit, listës minimale të mallrave dhe shërbimeve, si dhe të dhënave teknike e cilësore të tyre.
2. Procedurat e prokurimit për plotësimin e nevojave emergjente të autoriteteve kontraktore dhe lidhjen e kontratave publike nga ana e tyre, për mallra dhe shërbime të nevojshme për



përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë, do të kryhen për objektet e prokurimit si më poshtë:


- a) **“Blerje materiale të nevojshme për mbrojtjen personale”** (të lidhura ngushtësisht dhe të nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19, për nevojat e punonjësve të autoriteteve kontraktore.
  - b) **“Shërbime dezinfektimi”** (të lidhura ngushtësisht dhe të nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga COVID-19, të ambienteve të brendshme dhe/ose të jashtme të autoriteteve kontraktore);
3. Lista e mallrave dhe shërbimeve, të dhënat teknike e cilësore të tyre, të vlerësuara të nevojshme për secilin nga objektet e prokurimit të sipërpërmendura, është sipas Aneksit 1, bashkëngjitur këtij Udhëzimi. Në këtë listë janë përfshirë artikujt dhe shërbimet minimale të higjenës dhe masave mbrojtëse, të rekomanduara për autoritetet kontraktore dhe punonjësit e tyre, për kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID-19.
  4. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, do të kryejë inspektime sistematike në autoritetet kontraktore, gjatë gjithë kohëzgjatjes së periudhës së epidemisë COVID-19, me qëllim verifikimin e kryerjes dhe përputhshmërisë së të dhënave teknike e cilësore, të mallrave dhe shërbimeve të përcaktuara në Aneksin 1 të këtij Udhëzimi, përkundrejt zbatimit të penaliteteve në fuqi ndaj personave përgjegjës.
  5. Ky udhëzim dhe lista e mallrave dhe shërbimeve bashkëngjitur udhëzimit, nuk zbatohen për institucionet e kujdesit shëndetësor, të cilët ndjekin udhëzime të posaçme të MSHMS, të nxjerra për këtë qëllim.

Ky Udhëzim hyn në fuqi sot në datë 6.05.2020.

**Për Agjencinë e Prokurimit Publik**

Drejtor i Përgjithshëm

**Reida Kashta**



**Për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**

Sekretar i Përgjithshëm

**Gelardina Prodani**





**Aneksi 1 - Lista e mallrave dhe shërbimeve, të dhënat teknike e cilësore.**

**Tabela 1 - Blerje materiale të nevojshme për mbrojtjen personale**

Nr.	Emërtimi i artikullit	Të dhënat teknike e cilësore të mallrave	Njësia matëse / paketimi
1	Maska	<p><b>Maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP3</b>, me ose pa valvul, me një përdorim, me lidhëse pas veshit ose pas kokës, të mbrojnë hundën dhe gojën, të puthitet lehtësisht me fytyrën dhe hundën, të mos shkaktojë probleme me frymëmarrjen, të ketë përshkueshmëri të mirë të ajrit, me nivel filtrimi të ajrit <math>\geq 95\%</math>, hipoalergjike, pa fibra qelqi, të jetë rezistente ndaj agjentëve biologjikë, aerosoleve, yndyrave, ujit, etj. Të plotësojë kërkesat e standardit european EN 149: 2001 + A1: 2009 ose standardit amerikan NIOSH 95 ose ekuivalent. Të ketë certifikimin CE ose FDA ose ekuivalent. Afati i skadencës të jetë të jetë të paktën 6 muaj nga koha e furnizimit. Të ambalazhuara në mënyrë të tillë që të mos kontaminohen gjatë shpërndarjes.</p> <p><b>Maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP2 (N95)</b>, me ose pa valvul, me një përdorim, me lidhëse pas veshit ose pas kokës, të mbrojnë hundën dhe gojën, të puthitet lehtësisht me fytyrën dhe hundën, të mos shkaktojë probleme me frymëmarrjen, të ketë përshkueshmëri të mirë të ajrit, me nivel filtrimi të ajrit <math>\geq 95\%</math>, hipoalergjike, pa fibra qelqi, të jetë rezistente ndaj agjentëve biologjikë, aerosoleve, yndyrave, ujit, etj. Të plotësojë kërkesat e standardit european EN 149: 2001 + A1: 2009 ose standardit amerikan NIOSH 95 ose ekuivalent. Të ketë certifikimin CE ose FDA ose ekuivalent. Afati i skadencës të jetë të jetë të paktën 6 muaj nga koha e furnizimit. Të ambalazhuara në mënyrë të tillë që të mos kontaminohen gjatë shpërndarjes.</p> <p><b>Maskë kirurgjikale e thjeshtë</b>, me një përdorim, me lidhëse pas veshit ose pas kokës, të mbrojnë hundën dhe gojën, me përshtatës për hundën, të mos shkaktojë probleme me frymëmarrjen, të ketë përshkueshmëri të mirë të ajrit, me nivel filtrimi të ajrit <math>\geq 99\%</math>, hipoalergjike, me copë të pathurur me 3 shtresa me palosje, celuloze, poliester, fibër, me formë drejtkëndëshe e sheshtë, me nivel të mirë mbrojtje, me dimensione 90mm x 180mm (<math>\pm 10</math>mm). Afati i skadencës të jetë të jetë të paktën 6 muaj nga koha e furnizimit. Të ambalazhuara në mënyrë të tillë që të mos kontaminohen gjatë shpërndarjes.</p> <p><b>Maskë prej pëlhure</b> që lahet në 60 gradë dhe hekuroset</p>	copë
2	Doreza	Doreza Latex ose Nitrile, josterile, me ose pa pudër, njëpërdorimshe, në masat XS, S, M, L, XL (sipas kërkesës së punonjësve), të jenë të paketuara në pako kartoni ose plastike, me minimumi 100 copë doreza. Të ketë certifikimin CE ose FDA ose ekuivalent. Afati i skadencës të jetë të jetë të paktën 6 muaj nga koha e furnizimit. Të ambalazhuara në mënyrë të tillë që të mos kontaminohen gjatë shpërndarjes.	pako



3	<b>Sapun për duar</b>	Sapun i lëngshëm, anti-bakterial ose anti-mikrobial, me aftësi shkumuese të lartë, lartësia e shkumës jo më e vogël se 5 cm, e butë për lëkurën dhe e testuar dermatologjikisht, me paketim plastik minimumi 250 ml.	flakon
5	<b>Xhel dezinfektues për duar</b>	Materiali xhel për desinfektimin e duarve, me bazë alkooli të paktën 60%, antiseptik i shpejtë dhe dezinfektues efektiv, i gatshëm për t'u përdorur pa nevojën e përdorimit të ujit për shplarje, anti-bakterial ose anti-mikrobial për zvogëlimin e shkaktarëve të infeksioneve, me paketim plastik minimumi 50 ml (për përdorim nga punonjësit jashtë zyre) dhe minimumi 500 ml (për përdorim nga punonjësit brenda zyre).	flakon
6	<b>Alkool</b>	Alkool etilik i denaturuar ose alkool izopropilik, me përqendrim 70% – 95%, antiseptik, dezinfektues për përdorim të jashtëm, me veprim dezinfektues me spektër të gjerë veprimi ndaj viruseve, bakterieve, grameve, etj. Me paketim plastik minimumi 100 ml (për përdorim nga punonjësit jashtë zyre) dhe minimumi 1000 ml (për përdorim nga punonjësit brenda zyre).	flakon
7	<b>Dezinfektues për sipërfaqe</b>	Dezinfektues i lëngshëm, pa shpëlarje, antibakterial ose antimikrobial, i përshtatshëm për të gjitha llojet e sipërfaqeve (mobilje, doreza dyersh, tastiera, telefona, xhama, parmak, dysheme, etj.). Të ketë veprim dezinfektues me spektër të gjerë veprimi ndaj viruseve, bakterieve, grameve, etj. në përbërje të të cilit të ketë agjentë antimikrobialë ose antibakterialë. Të ketë veprim pastrues dhe dezinfektues shumë të mirë. Me paketim plastik dhe me tapë për sprucim, me minimumi 500 ml (për mobilje, doreza dyersh, tastiera, telefona, xhama, etj). Me paketim plastik me minimumi 1000 ml (për parmakë, dysheme, etj).	flakon
8	<b>Termometër infrared</b>	Të realizojë matjen e temperaturës së trupit të njeriut në një distancë matje 3-5 cm; të ketë diapazon matje 32° - 42.9 °C ose 89.6°F - 109.2°F; me rezolucion 0.1° C/0.1°F; në lagështi relative ≤90%; Saktësia sipas standardit ASTM E1965-1998 (2003) ose ekuivalent: - 30 - 34.9°C (±0.3°C) - 35 - 42°C (±0.2°C) - 42.1 - 42.5°C (±0.3°C) Termometri të ketë mundësi ushqimi me bateri; Të ketë certifikimin CE ose FDA ose ekuivalent.	copë

**Tabela 2 - Shërbime dezinfektimi**

Nr.	Emërtimi i shërbimit	Të dhëna teknike e cilësore të shërbimit	Njësia matëse
1	<b>Dezinfektim i ambienteve të brendshme</b>	<b>Shërbim i dezinfektimit të ambienteve të brendshme</b> , të mbyllura, të institucioneve të ndryshme (psh: zyra, ambiente pritje, korridore, tualete, magazina, arkiva, automjete, etj).  <b>Të dhënat teknike të produkteve Biocide:</b> Dezinfektimi i ambienteve të brendshme duhet të kryhet me dezinfektant. Produktet Biocide që do të përdoren për dezinfektim, duhet të rezultojnë në listën e lëndëve që përdoren për dezinfektim, të miratuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe	metra katror (m <sup>2</sup> ) ose metra kub (m <sup>3</sup> )



	<p>Mbrojtjes Sociale.</p> <p>Produktet Biocide që do të përdoren, duhet të jenë vetëm “për përdorim profesional”.</p> <p>Produktet Biocide që do të përdoren, duhet të jenë të përshtatshme për t’u aplikuar në ambiente të brendshme, të tilla si: godina institucionesh, gazerma, magazina, automjete, etj.</p> <p>Produktet Biocide duhet të japin efekt sa më të shpejtë dezinfektues të kenë veprim baktericid, fungicid dhe virusicid të zgjatur në kohën e përcaktuar.</p> <p>Produktet Biocide nuk duhet të shkaktojnë efekte anësore që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e njerëze, kafshëve dhe bimëve, si dhe nuk duhet të kenë ndikim negativ në mjedis.</p> <p>Nuk duhet të përdoret asnjë produkt apo preparat që mund të shkaktojë dëme në shëndetin e njerëzve dhe në ekosistem.</p> <p><b>Terma reference të shërbimit:</b></p> <p>Përpara kryerjes së çdo shërbimi, sipas sasive dhe grafikut të kërkuar nga autoritetet kontraktore, personi përgjegjës (drejtues teknik) i operatorit ekonomik duhet të bëjë fillimisht inspektimin e situatës dhe terrenit të jashtëm e të brendshëm, për të përcaktuar në mënyrë sa më të saktë që të jetë e mundur, vendet e nevojshme dhe më të përshtatshme, në cilat duhet të kryhen shërbimet që të jenë sa më efektive.</p> <p>Sipas frekuencës së kërkuar të shërbimit, personi përgjegjës (drejtues teknik) i operatorit ekonomik duhet të bëjë monitorimin e situatës dhe verifikimin e rezultatit të shërbimit në pikat kritike. Nëse shërbimi nuk ka dhënë rezultat, duhet të bëhet rivlerësim i pikave apo vendeve kritike, duke përsëritur shërbimin. Operatori ekonomik duhet të jetë në dispozicion të autoritetit kontraktor edhe në rastet e thirrjeve emergjente, me detyrimin për t’u përgjigjur me të gjitha mjetet e nevojshme, për kryerjen e shërbimeve brenda një kohe të shkurtër.</p> <p>Shërbimet duhet të kryhen nga specialistë të fushës me eksperiencë për përdorimin e produkteve me rrezikshmëri të lartë, në një kohë sa më të përshtatshme, pa cënuar mbarëvajtjen e punës së autoriteteve kontraktore dhe pa rrezikuar jetën e njerëzve. Punonjësit e operatorit ekonomik gjatë kryerjes së shërbimit të dezinfektimit duhet të jenë të pajisur me veshjen e përshtatshme mbrojtëse (maskë, syze, çizme, doreza, kapuc, veshje mbrojtëse specifike që mbulon gjithë pjesët e trupit, etj).</p> <p>Dezinfektimi duhet të kryhet sipas nevojave specifike të ambientit dhe ekspertizës higjieno-sanitare të ofruar nga operatori ekonomik, nëpërmjet mënyrave, si psh :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- me spërkatje mjegulluese në të ftohtë, me presion shumë të ulët, që garanton shpërndarjen e grimcave të imta të preparatit dhe mbulimin 100% të ambientit (kryesisht ambiente të vogla zyrash, automjete, etj.), me mjetet përkatëse (pompa / cantë shpine me presion / etj).</li> <li>- me spërkatje me presion të ulët minimumi 2 metra largësi, që garanton shpërndarjen e grimcave të vogla të preparatit dhe mbulimin 100% të ambientit (kryesisht sipërfaqe dysHEMEJE, muresh, mobiljesh, etj.), me mjetet përkatëse</li> </ul>	
--	--	--



		<p>(pompa / cantë shpine me presion / etj).</p> <p>- me spërkatje me presion të lartë minimumi 20 metra largësi (kryesisht sipërfaqe të mëdha zyresh, magazina, gazerma, etj.), me mjetet përkatëse (pompa / cantë shpine me presion / etj).</p> <p><b>Shpeshtësia e kryerjes së shërbimit:</b> të paktën 1 (një) herë në 20 ditë gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë, ose sipas nevojave të autoritetit kontraktor.</p>	
2	<b>Dezinfektim i ambienteve të jashtme</b>	<p><b>Shërbim i dezinfektimit të ambienteve të jashtme, të hapura,</b> të institucioneve të ndryshme (psh: holle të hapura, sheshe pushimi, ambiente pritje jashtë, rrugica hyrëse - dalëse, mure të jashtme godine, mure rrethuese, etj).</p> <p><b>Të dhënat teknike të produkteve Biocide:</b>  Dezinfektimi i ambienteve të jashtme duhet të kryhet me dezinfektant. Produktet Biocide që do të përdoren për dezinfektim, duhet të rezultojnë në listën e lëndëve që përdoren për dezinfektim, të miratuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.  Produktet Biocide që do të përdoren, duhet të jenë vetëm “për përdorim profesional”.  Produktet Biocide që do të përdoren, duhet të jenë të përshtatshme për t’u aplikuar në ambientet e jashtme të institucioneve, të tilla si: holle të hapura, sheshe pushimi, ambiente pritje jashtë, rrugica hyrëse - dalëse, mure të jashtme godine, mure rrethuese, etj.  Produktet Biocide duhet të japin efekt sa më të shpejtë dezinfektues të kenë veprim baktericid, fungicid dhe virusicid të zgjatur në kohën e përcaktuar.  Produktet Biocide nuk duhet të shkaktojnë efekte anësore që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e njerëze, kafshëve dhe bimëve, si dhe nuk duhet të kenë ndikim negativ në mjedis.  Nuk duhet të përdoret asnjë produkt apo preparat që mund të shkaktojë dëme në shëndetin e njerëzve dhe në ekosistem.</p> <p><b>Terma reference të shërbimit:</b>  Përpara kryerjes së çdo shërbimi, sipas sasive dhe grafikut të kërkuar nga autoritetet kontraktore, personi përgjegjës (drejtues teknik) i operatorit ekonomik duhet të bëjë fillimisht inspektimin e situatës dhe terrenit të jashtëm e të brendshëm, për të përcaktuar në mënyrë sa më të saktë që të jetë e mundur, vendet e nevojshme dhe më të përshtatshme, në cilat duhet të kryhen shërbimet që të jenë sa më efektive.  Sipas frekuencës së kërkuar të shërbimit, personi përgjegjës (drejtues teknik) i operatorit ekonomik duhet të bëjë monitorimin e situatës dhe verifikimin e rezultatit të shërbimit në pikat kritike. Nëse shërbimi nuk ka dhënë rezultat, duhet të bëhet rivlerësim i pikave apo vendeve kritike, duke përsëritur shërbimin. Operatori ekonomik duhet të jetë në dispozicion të autoritetit kontraktor edhe në rastet e thirrjeve emergjente, me detyrimin për t’u përgjigjur me të gjitha mjetet e nevojshme, për</p>	metra katror (m <sup>2</sup> )



	<p>kryerjen e shërbimeve brenda një kohe të shkurtër.</p> <p>Shërbimet duhet të kryhen nga specialistë të fushës me eksperiencë për përdorimin e produkteve me rrezikshmëri të lartë, në një kohë sa më të përshtatshme, pa cënuar mbarëvajtjen e punës së autoriteteve kontraktore dhe pa rrezikuar jetën e njerëzve. Punonjësit e operatorit ekonomik gjatë kryerjes së shërbimit të dezinfektimit duhet të jenë të pajisur me veshjen e përshtatshme mbrojtëse (maskë, syze, çizme, doreza, kapuc, veshje mbrojtëse specifike që mbulon gjithë pjesët e trupit, etj).</p> <p>Dezinfektimi të kryhet sipas nevojave specifike të ambientit dhe ekspertizës higjeno-sanitare të ofruar nga operatori ekonomik, nëpërmjet mënyrave, si psh:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- me spërkatje me presion të ulët minimumi 2 metra largësi, që garanton shpërndarjen e grimcave të vogla të preparatit dhe mbulimin 100% të ambientit (kryesisht për spërkatje sipërfaqesh dysHEMEJE, muresh të jashtme, muresh rrethuese, etj.), me mjetet përkatëse (pompa / cantë shpine me presion / mjete lëvizëse / etj);</li> <li>- me spërkatje mjegulluese në të nxehtë, minimumi 10 metra largësi (kryesisht për sipërfaqe rrugica hyrëse - dalje, sheshe pushimi, holle të hapura, etj.), me mjetet përkatëse (pompa / cantë shpine me presion / mjete lëvizëse / etj).</li> </ul> <p><b>Shpeshtësia e kryerjes së shërbimit:</b> të paktën 1 (një) herë në 25 ditë, gjatë gjithë kohëzgjatjes së epidemisë, ose sipas nevojave të autoritetit kontraktor.</p>	
--	--	--

[Shqipitari]